



Drejtoria e
Përgjithshme e
Tatimeve



AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGROJARA
AGENCY FOR THE DELIVERY OF
INTEGRATED SERVICES ALBANIA

Nr. 12022, datë 26.5.2017

Nr. 563, datë 22.05.2017

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

LIDHUR NDËRMJET

PALËVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (ne vijim DPT), me seli në adresën: Rr. Gjin Bue Shpata (pas Stadiumit "Selman Stërmasi") Tiranë, i cili është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, **përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Vasilika VJERO**

DHE

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara - ADISA (në vijim ADISA), me seli në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", i cili është një institucion publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 13, datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", **përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Znj. Anisa GJIKÀ.**

Palët, së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "**Marrëveshja**"), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Në Marrëveshje midis tyre, palët bien dakord që brenda ambienteve të *Qendrës së Integruar për Ofrimin e Shërbimeve Publike në Gjirokastrë (në vijim QENDRA)*, e cila administrohet nga ADISA, Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë do t'i vihet në dispozicion 2 (dy) sportele të

dedikuar, për ofrimin e shërbimeve të saj dhe 1 (një) post pune për përgjegjësin. Këto shërbime ofrohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Neni 2

Baza Ligjore

Ligji Nr. 13, datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Neni 119 dhe 121 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), dhe nenet 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

Neni 3

Afati i Marrëveshjes

- 3.1 Afati i kësaj Marrëveshje është 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Ky afat mund të ndryshohet përmes një marrëveshje me shkrim midis palëve.
- 3.2 Kjo marrëveshje do të rishikohet pas kalimit të një periudhe 3 (tre) mujore, gjatë të cilës do të testohet fluksi i aplikimeve, në lidhje me numrin e sporteleve objekt marrëveshje dhe do të vlerësohen hapësirat në dispozicion brenda QENDRËS.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr përsipër të transferojë sportelet e shërbimit ndaj tatimpaguesve në Gjirokastrë dhe postin e punës për përgjegjësit të tyre, nga ambientet ku janë të vendosura aktualisht, në ambientet e QENDRËS të vëna në dispozicion nga ADISA pa kundër shpërblim.
- 4.2 Të bëjë të mundur funksionimin e sistemit të DPT të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të saj në sportelet e QENDRËS.
- 4.3 Të vëre në dispozicion punonjësit, që do të vendosen në sportelet/postet e punës, në përdorim brenda QENDRËS, të cilët duhet të respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.
- 4.4 Punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë kanë detyrimin të marrin pjesë në trajnimet që organizohen nga ADISA në kuadër të përmirësimit të shërbimeve publike.
- 4.5 Të pranojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimit ndaj tatimpaguesve të mbledhura nga punonjësit e ADISA-s, pranë QENDRËS dhe që i përcillen me shkrim në fund të

çdo dite. Ato duhet të shqyrtohen brenda afatit ligjor dhe në varësi të shkëljes duhet të marrë, masat e nevojshme ndaj punonjësve përkatës.

- 4.6 Të ushtrojë të gjitha detyrat operationale të ngarkuara mbështetur në ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj, në hapësirën e caktuar ashtu si janë ushtruar edhe përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
- 4.7 Të mirëmbajë të gjitha mobiliat, pajisjet dhe mjetet e tjera të dhëna në përdorim nga ADISA gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes dhe t'i dorëzojë ato në gjendje pune në momentin e përfundimit të Marrëveshjes.
- 4.8 Të kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të marra në përdorim deri në kthimin e tyre në përfundim të Marrëveshjes.
- 4.9 Të sigurojë bazën materiale të domosdoshme për funksionimin e sporteleve të saj dhe ofrimin e shërbimeve.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ADISA

- 5.1 ADISA merr përsipër që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes t'i vërë në dispozicion pa kundër shpërblim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë), ambientet për funksionimin e 2(dy) sporteleve dhe 1 (një) post pune për përgjegjesin, të branduara nga ADISA, të mobiluara (post pune i kompletuar me tavolinë, karrige, raft) dhe pajisjet e nevojshme IT (kompjuter, printer, skaner, linjë interneti, fotokopje), duke siguruar kushte normale pune dhe akses nga publiku.
- 5.2 Të trajnojë punonjësin që do të shërbejë në sportel në lidhje me etikën e komunikimit, modelet e sjelljes, manaxhimit të presionit në punë etj, me qëllim edukimin e tyre për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më të shpejtë dhe cilësore për qytetarin.
- 5.3 Të sigurojë sistemin e menaxhimit të radhës, në mënyrë elektronike dhe të përbashkët për të gjitha sportelet e QENDRËS, përfshirë këtu dhe sportelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë).
- 5.4 Të sigurojë informacion për publikun nëpërmjet info-point dhe punonjësit përkatës në lidhje me shërbimet e ofruara nga sporteli i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë.
- 5.5 Të mbledhë dhe administrojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar nga punonjësi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë dhe t'ia përcjellë me shkrim kësaj të fundit.
- 5.6 Titullari i ADISA-s kërkon zëvendësimin e punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë), nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas treguesve të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në sportel. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve zëvendëson punonjësin menjëherë.
- 5.7 Të marrë në dorëzim në përfundim të Marrëveshjes ambientet e dhëna në përdorim, mobiliat dhe pajisjet në gjendjen që i ka dorëzuar, duke konsideruar amortizimin normal të tyre.

Neni 6

Nëpunësit e sportelit, të drejtat dhe detyrimet e tyre

- 6.1 Nëpunësi i sportelit dhe përgjegjësi janë nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë), të emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 6.2 Marrëdhënia e tyre e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet te ADISA gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
- 6.3 ADISA nuk ka detyrime financiare ndaj punonjësve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë, i cili shërben në sportelin e vendosur në hapësirat e QENDRËS.

Neni 7

Shpenzimet për funksionimin e sporteleve

- 7.1 Shpenzimet për funksionimin e Sportelit/postit përballohen nga fondet e DPT dhe mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësin e sportelit, si dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e sporteleve të shërbimit.
- 7.2 ADISA merr përsipër të sigurojë vënien në dispozicion të posteve të punës brenda ambienteve të QENDRËS, të pajisura me mobilie, pajisje IT dhe furnizim me internet, siç është përcaktuar në nenin 5/1. Këto pajisje jepen në përdorim gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, por mbeten në pronësi të ADISA, e cila merr përsipër edhe amortizimin normal të tyre.

Neni 8

Orari i funksionimit të sportelit

- 8.1 Orari i pranimit të aplikimeve për sportelin është:
E hënë - E premte ora 08:00 - 14:00
- 8.2 Orari gjatë të cilit ambientet e ADISA-s mund të përdoren nga punonjësi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë, sipas kësaj Marrëveshje është 08:00-16:30, nga e hëna deri të enjte dhe 08:00-14:00 ditën e premte.
- 8.3 Përgjegjësi i sporteleve të QENDRËS do të raportojë për paraqitjen e punonjësit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë çdo ditë zyrës së burimeve njerëzore të saj.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit

- 9.1 Procesi i aplikimit në sportel do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të DPT dhe Ligjit 13/2016 "Për ofrimin e shërbimeve publike

në sportel në RSH” për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me rregullimet ligjore aktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve.

- 9.2 Me kërkesë të ADISA-s, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë i vë në dispozicion kësaj të fundit raporte në lidhje me aplikimet dhe afatet e përgjigjeve.
- 9.3 Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve vë në dispozicion punonjësit të info-point të ADISA, pranë QENDRËS materiale informuese të saj, si broshura dhe informacione të tjera në lidhje me aplikimin dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Neni 10

Zgjidhja e Marrëveshjes

- 10.1 Marrëveshja përfundon me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj.
- 10.2 Marrëveshja mund të zgjidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në rast se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimit nga ADISA, si:
- Vënia në dispozicion e posteve të punës;
 - Vënia në dispozicion e mobilieve dhe pajisje IT;
 - Furnizimi me internet.
- 10.3 Marrëveshja mund të zgjidhet nga ADISA në rast se:
- Punonjësit e DPT-së nuk respektojnë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel;
 - DPT nuk siguron funksionimin normal të sistemit;
 - DPT nuk siguron bazën materiale për funksionimin e sporteleve dhe ofrimin e shërbimit;
 - DPT nuk respekton detyrimet e tjera të parashikuara sipas Nenit 4.
- 10.4 Marrëveshja mund të zgjidhet përpara përmbushjes së afatit për shkaqe të arsyeshme me kërkesë të njërës palë, duke njoftuar palën tjetër me shkrim, të paktën një muaj para.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptimin midis palëve.

Neni 12

Hyrja në fuqi

- 12.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 13
Dispozita të fundit

13.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe secila palë mban 2 (dy) kopje të njëjta.


PALËT

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**

Përfaqësuar nga :
DREJTORI PËRGJITHSHËM
Vasilika VJERO

**AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**

Përfaqësuar nga :
DREJTOR EKZEKUTIV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)**

Nr. 563/2 Prot.

Tiranë, më 04.05.2018

**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E TATIMEVE**

Nr. 12022/2 Prot.

Tiranë, më 04.5.2018

SHTOJCË

Për një ndryshim në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet ADISA (Nr.563, datë 22.05.2017) dhe DPT (Nr.12022, datë 25.05.2017)

Sot në Tiranë në datë 04/05/2018 lidhet kjo Shtojcë Marrëveshje

NDËRMJET

Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara - ADISA (në vijim ADISA) me seli në Bulevardin Zhan D'Ark, i cili është një institucion publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit nr.13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Znj. Anisa GJIKA:

DHE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (ne vijim DPT), me seli në adresën: Rr. Gjin Bue Shpata (pas Stadiumit "Selman Stërmasi") Tiranë, i cili është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Vasilika VJERO

të cilët këtu e më poshtë do të njihen si "*palër*", lidhin këtë marrëveshje

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

Kjo Marrëveshje rinovohet dhe i shtrin efektet për një periudhë kohe të pacaktuar.

Neni 2

Të gjitha parashikimet e tjera të kësaj Kontrate mbeten në fuqi dhe të pandryshuara për aq sa nuk bien në kundërshtim me nenin 1.

Neni 3

Kjo Shtojcë marrëveshje, mbahet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje, nga një për secilën palë, dhe ministritë e linjës, nënshkruhet dhe hyn në fuqi sot më datë. ____/____/2018.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

PËR

**AGJENCINË E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)**

DREJTOR EKZEKUTIV

Anisa GJIK



PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
TATIMEVE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vasilika VJERO

